

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6898  
E enjte, 18 maj 2023  
Çmimi 0.40 €

KDI-ja kërkon ndëshkimin e deputetëve që nuk marrin pjesë rregullisht në seanca | **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

EDI RAMA PËRSËRI U DEL NË MBROJTJE HASHIM THAÇIT  
DHE USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS | **FAQE 4-5**

## RAMA NË SAMITIN E LIDERËVE NË ISLANDË: GJYKIMI I HASHIM THAÇIT, I PABAZË DHE DJALLËZËR



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nuk heziton ta thotë të vërtetën për luftën çlirimtare të Kosovës dhe të liderëve të saj sa herë që i jepet mundësia. Këtë herë ai e ka shfrytëzuar Samitin e Këshillit të Evropës (KE) në

Islandë për të folur në lidhje me gjykimin që është duke u mbajtur në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Kryeministri i Shqipërisë ka theksuar se gjykimi i Thaçit dhe i të tjerëve është i

pabazë dhe, sipas tij, zanafillën e ka në Rusi. Rama ka thënë se raporti i Dick Martyt ishte sponsorizuar në mënyrë djallëzore nga njerëzit e Putinit për t'i njollosur Shqipërinë dhe Kosovën

### AKTUALE



VËRSHIME NË KROACI DHE BOSNJË-HERCEGOVINË | **F. 2**

KURTI BASHKËBESON ME STUDENTËT E AKADEMISË DIPLOMATIKE TË VJENËS | **F. 7**

AKSION KUNDËR FAJDESE NË PRISHTINË DHE PODUJEVË, BASTISEN SHTËPI DHE LOKALE | **F. 6**

### EKONOMI



PDK-ja INICION NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TATIMIN NË PRONË | **F. 8**

BRENDA PAK JAVËSH HAPEN PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN E URËS SË RE NË BADOVC | **F. 8**

### SPORT



SONTE NË 'MINATORI' VENDOSËT TITULLI I KAMPIONIT | **F. 10**

DASH- PUBLIKON RAPORTIN PËR LIRINË FETARE. CILAT JANË PROBLEMET NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE MAQEDONINË E VERIUT? | **FAQE 3**



CAKTOHEN DATAT PËR ZGJEDHJET EVROPIANE | **FAQE 5**



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Vërshime në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë

**SARAJEVË, 17 MAJ** - Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia ditët e fundit janë përballur me vërshime për shkak të reshjeve të mëdha të shiut. Lumenjtë Una dhe Krushnica kanë dalë prej shtretërve. Në Bosnjë është shpallur gjendje e jashtëzakonshme në komunat Novi Grad, Kostajnica, Bosanska Krupa dhe Bihaq.

Në Komunën e Novi Gradit nuk do të mbahet procesi mësimor, as në Obrovac të Kroacisë. Disa vende është raportuar të kenë mbetur pa energji elektrike. Disa banorë janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, por shkalla e dëmeve nuk dihet ende. Në Kroaci rreth 300 trupa

ushtarake janë aktivizuar për t'iu ndihmuar njerëzve në nevojë, kanë thënë autoritetet. Ekipet është thënë se u kanë dërguar ushqime banorëve të bllokuar në shtëpitë e tyre. Kryeministri kroat Andrej Plenković ka bërë me dije se qeveria do të ndajë fonde për t'iu ndihmuar personat e prekur nga vërshimet.



## Bideni dhe republikanët shpresojnë se do të arrijnë marrëveshje për tavan të borxhit

**WASHINGTON, 17 MAJ** - Presidenti amerikan Joe Biden dhe liderët republikanë kanë shprehur optimizëm me rezervë nëse mund të arrihet një marrëveshje për ta rritur tavanin e borxhit qeveritar. Udhëheqësi i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, u ka thënë gazetarëve, pas takimit, se të dyja palët kanë ende dallime në qëndrime. Kjo bllokadë e ka detyruar presidentin Biden të shkurtojë një udhëtim jashtë vendit. Pa arritur një marrëveshje Shtetet e Bashkuara do të mund të përballen me borxh në vlerë prej 31.4 trilionë dollarëve prej 1 qershorit. Dështimi eventual i qeverisë amerikane për t'i paguar

obligimet e borxhit rrezikon edhe kaos global financiar. Presidenti Biden ka thënë të martën se takimet disaorëshe në Zyrën Ovale kanë qenë "të mira dhe produktive". Në takim kanë marrë pjesë demokratë në pozita të larta, përfshirë nënpresidenten Kamala Harris, shefin e shumicës në Senat, Chuck Schumer dhe udhëheqësin e pakicës në Dhomën e Përfaqësuesve, Hakeem Jeffries. Në këmbim të ofrimit të mbështetjes për rritje të tavanit të borxhit, liderët republikanë janë duke kërkuar shkurtime buxhetore. Ata po kërkojnë edhe ashpërsimin e kërkesave për pranuesit e ndihmës qeveritare.



Bideni do të udhëtojë të mërkurën për në Japoni për të marrë pjesë në samitin e shtatë

vendeve më të industrializuara, G7. Planet kanë qenë që ai më pas të

shkojë në Papa Guinenë e Re dhe në Australi, mirëpo ato udhëtime janë anuluar. Prekja e tavanit të borxhit nënkupton që qeveria amerikane nuk mund të huazojë më shumë para. Kjo do të thotë se qeveria nuk mund t'i paguajë më pagat e punëtorëve federalë dhe të atyre ushtarakë. Edhe pagesat për pensionistët do të ndalen. Kongresi amerikan ka votuar shpesh në të kaluarën për ta rritur tavanin e borxhit. Një mosmiratim i rritjes së tavanit mund ta shembë besimin në politikën amerikane dhe aftësinë e saj për t'i paguajë faturat. Ekspertët kanë paralajmëruar se ekonomia amerikane mund të përballë edhe me recesion dhe rritje të shkallës së papunësisë.

## OKB-ja: Ndotja me plastikë mund të zvogëlohet për 80 për qind me riciklim dhe ripërdorim

**NAIROBI, 17 MAJ** - Ndotja me plastikë mund të zvogëlohet për 80 për qind deri më 2040 nëse shtetet dhe kompanitë hartojnë politika dhe bëjnë ndryshime në tregje, ka thënë Programi i Kombeve të Bashkuara për Ambient (UNEP). Për të arritur në atë pikë, OKB-ja ka thënë se duhet të punohet më shumë në ripërdorim, riciklim dhe riorientim të produkteve të plastikës. Sipas ekspertëve të OKB-së, kjo nënkupton që qeveritë duhet të promovojnë shishe që rimbushen dhe skema të rikthimit të



produkteve të plastikës. Mes të tjerash, ata kanë thënë se ndotja me plastikë mund të ulet, edhe nëse riciklimi bëhet më i qëndrueshëm dhe fitimprurës. Shefja ekzekutive e UNEP-it, Inger Andersen, ka thënë se mënyra sesi prodhojmë, përdorim dhe e hedhim plastikën është duke ndotur ekosistemet, po krijon rreziqe për shëndetin e njeriut dhe po e destabilizon klimën. Raporti i kësaj agjencie, që flet për mënyrat e dhënies fund të përdorimit të plastikës, është publikuar pas një raundi të dytë të negociatave në Paris, ku është

analizuar trendi global për ta luftuar ndotjen me plastikë. Sipas agjencisë, ndryshimi i politikave në përdorim të plastikës mund të krijojë mbi 700 000 vende të punës deri më 2040, kryesisht në shtete me të hyra të vogla. Produktet e plastikës janë gjetur në pothuajse secilin kënd të botës, përfshirë Antarktikën. Më herët gjatë këtij viti shkencëtarët kanë identifikuar te zogjtë sëmundjen e parë të shkaktuar nga plastika. E quajtur plasticosis, kjo sëmundje shkakton inflamacion në traktin tretës.

## Ish-presidenti Sarkozy humb apelin në rastin për korrupsion

**PARIS, 17 MAJ** - Ish-presidenti francez Nicolas Sarkozy e ka humbur apelin kundër një dënimi me burgim për korrupsion. Megjithatë, Gjykata e Apelit në Paris ka marrë vendim që ai mund të qëndrojë në arrest shtëpiak në vend të shkuarjes në burg. Më 2021 Sarkozy është dënuar me tre vjet burgim për

tentimet që të ndikojë te një gjyqtar në një rast gjyqësor. Sarkozy, 67-vjeçar, është ish-presidenti i parë francez që është dënuar me burgim. Ai është dënuar pasi, sipas gjykatës, Sarkozy ka tentuar të sigurojë informacion për një rast më 2014 pasi është larguar nga pushteti duke sugjeruar se mund t'ia garantojë gjyqtarit

një pozitë prestigjioze. Nicolas Sarkozy ka shërbyer një mandat pesëvjeçar si president që prej vitit 2007. Ai i ka miratuar disa politika të ashpra kundër migrimit dhe ka tentuar ta reformojë ekonominë e Francës. Por, në atë periudhë e gjithë bota është përballur me krizë financiare.



# DASH-i publikon raportin për lirinë fetare. Cilat janë problemet në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut?



**PRISHTINË, 17 MAJ** - Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin vjetor për gjendjen e lirisë fetare në botë gjatë vitit 2022. Në parathënie e raportit, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, vë në dukje se ndërsa vazhdojnë kufizime domethënëse nga qeveritë në mbarë botën ndaj praktikave fetare, njerëzit vazhdojnë të emigrojnë drejt Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera demokratike në kërkim të lirisë së besimit. Raporti përmban kapituj të veçantë për gjendjen e lirisë së besimit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

## Shqipëri

Në pjesën për Shqipërinë, raporti vë në dukje se qeveria shqiptare ka në fuqi marrëveshje me pesë komunitete fetare nëpërmjet të cilave i njeh këto grupe si komunitetet kryesore të besimit në vend dhe trajton brenda këtij kuadri çështjet e rikthimit të pronave dhe çështje të tjera. Qeveria shqiptare, megjithatë, ndihmon financiarisht vetëm katër prej tyre. Raporti përmend

se në gusht Dëshmitarët e Jehovahit ngritën një padi gjyqësore për shkak se qeveria shqiptare nuk i ishte përgjigjur kërkesës për arritjen e një marrëveshjeje të ngjashme si me pesë komunitetet e tjera të besimit.

Të pesë komunitetet fetare që kanë marrëveshje me qeverinë shqiptare raportuan probleme me procesin e rikthimit të pronave, ndërsa agjencia përkatëse shtetërore përmend kufizimet për shkak të zënies së territorit nga ndërtime të ligjshme dhe të paligjshme, si dhe hapësirat e pakta të disponueshme.

Në tërësi, komunitetet fetare në Shqipëri i përshkruajnë si pozitive marrëdhëniet mes besimeve, megjithëse Dëshmitarët e Jehovahit thonë se vazhdon raportimi nën një dritë negative nga disa media në vend, dhe se katër padi të ngritura ndaj këtyre medieve për shpifje që në vitin pararendës vazhdonin të ishin në proces gjyqësor.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë vazhdoi t'u bëjë thirrje zyrtarëve të qeverisë

shqiptare që të përshpejtojnë procesin e rikthimit të pronave dhe objekteve të tjera të konfiskuara gjatë epokës komuniste. Ambasada vazhdon të mbështesë programet për të rinjtë, për nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe fuqizimin e rolit të grave në komunitetet fetare.

## Kosovë

Megjithëse kushtetuta e vendit ndalon diskriminimin fetar dhe garanton lirinë e besimit, legjislacioni i vendit nuk ofron mundësinë për grupet fetare që të fitojnë status ligjor.

Policia i ndaloi Kishës Ortodokse Serbe mbajtjen e liturgjisë në një kishë të kontestuar dhe në disa shkolla të vendit vazhdoi zbatimin e një udhëzimi të qeverisë për ndalimin e veshjeve fetare, duke ua ndaluar kështu qasjen në mësimdhënie nxënësve që mbajnë hixhab. Pati raportime për diskriminim edhe në vende publike apo në mjediset e punës ndaj grave myslimane që mbajnë veshje fetare.

Qeveria e Kosovës vazhdon të mos

zbatojë një vendim të gjykatës të vitit 2016 për njohjen e pronësisë së Kishës Ortodokse Serbe të zonës përreth Manastirit të Deçanit, ndërsa Kisha Protestante Evangjeliste e Kosovës, Dëshmitarët e Jehovahit dhe grupe të tjera thanë se mungesa e mbështetjes institucionale për varreza të dedikuara ua mohoi të drejtën e varrimit sipas besimit të tyre.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë vazhdon ta inkurajojë qeverinë e Kosovës që të hartojë legjislacionin që do t'u mundësojë grupeve fetare marrjen e statusit ligjor, që do të krijonte mekanizmat për të mbrojtur lirinë e besimit dhe do të zgjidhte mosmarrëveshjet për pronësinë. Në një prej takimeve ndërfaqëse të ambasadës amerikane, për herë të parë u përfshinë drejtues të tarikatave, bektashinjve dhe të tjerë.

## Maqedoni e Veriut

Megjithëse kuadri kushtetues dhe ligjor i vendit garanton barazi përpara ligjit për të gjithë individët pavarësisht besimeve të tyre

fetare, pesë grupe fetare të krishtera, myslimane dhe hebraike përcaktohen si përfitues automatikisht nga përjashtimi për taksat dhe detyrime të tjera. Një grup pune i krijuar nga qeveria maqedonase në vitin 2021 vazhdoi të shqyrtojë amendamente ligjore për t'u mundësuar kishave dhe xhamive individuale marrjen e statusit si entitete ligjore. Qeveria maqedonase dhe Komuniteti i Bektashinjve të Tetovës vazhduan të kenë dallime për sa i përket regjistrimit të këtij grupi fetar. Ky komunitet nuk e riparaqiti kërkesën e tij për regjistrim të vitit 2000, për shkak të shqetësimeve se mund të shtrëngohej ta ndryshonte emrin e tij, duke rrezikuar kështu për rrjedhojë edhe vazhdimësinë e këtij komuniteti, që ka vazhduar të raportojë përmidje nga qeveria, nga vetë anëtarët e Komunitetit Fetar të Bektashinjve të regjistruar me qeverinë maqedonase, dhe të tjerë.

Grupet e krishtera dhe myslimane thonë se procesi i rikthimit të pronave vazhdon të jetë i ngadaltë dhe jo i plotë. Megjithëse u punua nga qeveria për të zgjidhur disa nga problematikat e akreditimit të shkollave të mesme fetare të drejtuara nga Komuniteti Fetar Mysliman i Maqedonisë së Veriut, çështja nuk u zgjidh, duke ua ndaluar kështu nxënësve regjistrimin në universitetet laike të vendit.

Njohja nëpërmjet kanonizimit nga Partia e Ekumenik i Kishës Ortodokse të Lindjes, i dha fund një periudhe të gjatë mosnjohjeje të Kishës Ortodokse të vendit, duke i çelur kështu edhe rrugën drejt arritjes së autoqefalisë.

Ambasada amerikane vazhdon të theksojë rëndësinë e dialogut ndërfaqëse dhe mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e qeverisë dhe drejtuesit e komuniteteve fetare për të diskutuar çështjet e lirisë së besimit, përfshirë edhe perceptimin për një favorizim nga qeveria maqedonase të disa grupeve të caktuara fetare, apo mënyrën e trajtimit të grupeve më të vogla fetare nga komunitetet kryesore në vend. (Voa)

## KDI-ja kërkon ndëshkimin e deputetëve që nuk marrin pjesë rregullisht në seanca

**PRISHTINË, 17 MAJ** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në një analizë të publikuar të mërkurën, ka kërkuar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe nga Kryesia e Kuvendit, t'i gjobitin në mënyrë të rregullt deputetët të cilët nuk marrin pjesë në seanca.

Në analizën e KDI-së është thënë se mungesa e kuorimit në seanca është duke penguar

përmbushjen e funksionit të këtij institucioni. "Ky problem, tashmë kronik, po e stërngarkon agjendën e Kuvendit, pasi pikat të cilat nuk po arrijnë të miratohen në një seancë, po barten në seanca të tjera. Për pasojë, jo rrallëherë rendi i ditës së një seance të vetme përmban 30 deri 60 pika për shqyrtim. Vetëm gjatë sesionit pranveror të këtij viti tri seanca janë

ndërprerë për shkak të mungesës së kuorimit, ndërsa nuk ka pasur kuorim për votim në shtatë seanca. Nga praktika e ndërprerjes së seancave, tash e dy javë Kuvendi ka shkuar një hap më tutje duke mos organizuar fare seanca për shkak të mungesës së kuorimit. Me mungesë të kuorimit janë përballur edhe komisionet parlamentare", thuhet në analizën e KDI-së.





EDI RAMA PËRSËRI U DEL NË MBROJTJE HASHIM THAÇIT DHE USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

# Rama në Samitin e Liderëve në Islandë: Gjykimi i Hashim Thaçit, i pabazë dhe djallëzor

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nuk heziton ta thotë të vërtetën për luftën çlirimtare të Kosovës dhe të liderëve të saj sa herë që i jepet mundësia. Këtë herë ai e ka shfrytëzuar Samitin e Këshillit të Evropës (KE) në Islandë për të folur në lidhje me gjykimin që është duke u mbajtur në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Kryeministri i Shqipërisë ka theksuar se gjykimi i Thaçit dhe i të tjerëve është i pabazë dhe, sipas tij, zanafillën e ka në Rusi. Rama ka thënë se raporti i Dick Martyt ishte sponsorizuar në mënyrë djallëzore nga njerëzit e Putinit për t'i njollësuar Shqipërinë dhe Kosovën

**EPOKA  
ERE**

**Lirim GECI**

**REIKJAVIK, 17 MAJ** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka marrë pjesë në Samitin e Këshillit të Evropës që është duke u mbajtur në Islandë. Rama fjalën e tij në këtë samit e ka nisur duke sjellë në vëmendje gjykimin e padrejtë që është duke u bërë liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Hagë, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. “Kërkoj ndjesë paraprakisht sepse më duhet të bëj një rrëfim jo fort të këndshëm. Si shqiptar është e pamundur për mua ta shmang heqjen e paraleleve midis Ukrainës e presidentit Zelensky dhe Kosovës e presidentit Thaçi. Sot në këtë Samit të Këshillit të Evropës nuk rri dot pa kujtuar se padrejtësia kundrejt luftës çlirimtare të Kosovës dhe udhëheqësit të saj Hashim Thaçi nisi saktësisht në Këshillin e Evropës nën ndikimin dashakeq të ish-anëtarit të asaj

kohe, të këtij Këshilli, Federatës Ruse. Presidenti i Kosovës, ose si dikush i quajtur Joe Biden, iu referua si George Uashingtoni i Kosovës, gjykohet tanimë nga një gjykatë e veçantë e ngritur dhe e themeluar nga bota demokratike, por e mbështetur në një raport të 2011-s të Këshillit të Evropës, i cili në mënyrë djallëzore u sponsorizua nga përfaqësuesit e partisë së Vladimir Putinit në Asamblenë e Këshillit të Evropës”, ka thënë Rama në tryezën me temën “Përballja me sfidat e reja dhe në zhvillim të drejtave të njeriut - e ardhmja është këtu”. Në këtë kontekst, kryeministri Rama ka thënë se raporti i Dick Martyt ishte hartuar për ta njollësuar imazhin e Shqipërisë dhe të Kosovës. Duke komentuar procesin gjyqësor në Hagë, Rama ka bërë një krahasim në mes të Hashim Thaçit dhe presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky. “Akuza tërësisht të pabazuara të trafikimit të organeve njerëzore u ngritën atëherë si pikënisja e një

fushate kriminale njollëseje të Shqipërisë dhe të Kosovës. Kur dëgjova propagandën e Kremlinit të flasë për trafikimin e organeve njerëzore nga neo-nazistët në Donbas, m'u duk sikur pashë presidentin Zelensky 10 vjet më vonë gjykuar nga një gjykatë e veçantë e ngritur mbi të njëjtat akuza absurde. Ndjesë për këtë hapje brutalisht jokonvencionale që mund t'ju duket sikur thyen në copa atë piano, ku në mënyrë të mrekullueshme u luajt kënga 'Ave Maria' nga mikpritësit tanë, por është tejet shkurajuese të dish që situata shqetësuese ku përfshihen presidenti i Kosovës dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës e pati zanafillën brenda Këshillit të Evropës”, ka thënë Rama. Kryeministri shqiptar në fjalimin e tij nuk është ndalur më kaq. Ai ka thënë se Këshilli i Evropës e ka për detyrim moral ta rishikojë çdo gabim në raport me liderët e UÇK-së. “Do të isha fajtor po të mbetesh i heshtur e të mos flisja sot këtu e të thosha

sa vijon, se Asambleja e Këshillit të Evropës ka detyrim moral të korrigjojë çdo gabim dhe në këtë rast duhet t'i hapë rrugën tërheqjes mbrapshtë raportit që në mënyrë të rreme etiketoi Shqipërinë si bazë për trafikimin e dyshuar të organeve lehtësuara nga UÇK-ja. Të refuzosh të përballësh me të vërtetën sot do të ishte më keq sesa të bëhej ky gabim i rëndë 12 vjet më parë, kur shumë votuan mes sy mbyllur atë raport të turpshëm në mirëbesim. Sigurisht sot situata ka ndryshuar. Rusia nuk është më një anëtare e këtij këshilli edhe pse numri i rusëve që vazhdojnë të punojnë për Këshillin e Evropës është mjaft mbresëlënës dhe falë Zotit uniteti i bashkësisë demokratikë të këshillit në mbështetje të luftës çlirimtare të Ukrainës dhe presidenti Zelensky është i jashtëzakonshëm”, ka thënë Rama, duke hedhur akuza në drejtim të Rusisë për luftën në Ukrainë. “Shqipëria kurrë nuk ka pasur iluzione për natyrën e regjimit të Moskës dhe marrëdhënja jonë me Moskën ka qenë joekzistuese qysh prej vdekjes së Josif Visarionoviç Stalinit. Mos më kërkoni të shpjegoj si e pse, se do të më duhej më shumë kohë se ç'iu desh udhëtimin tonë për në Islandë. Qysh prej fillimit të luftës popullariteti i Vladimir

Putinit është luhatur në Shqipëri nga 0.7 për qind në 1.2 për qind. Shqipëria është mjaft e vogël për të ndikuar fatet e një lufte kaq vendimtare për të ardhmen e Evropës dhe të botës, por çdo gjë të vogël që kemi bërë për Ukrainën e kemi bërë me mirënjohjen më të thellë ndaj qëndresës ukrainase. Kjo është arsyeja pse gjëja më e bukur që ne shqiptarët do të marrin nga ky samit kaq i mirë organizuar nga mikpritësit tanë islandezë”, është shprehur Rama. Kjo nuk është hera e parë që kryeministri Rama në forumet ndërkombëtare i del në mbrojtje Hashim Thaçit dhe luftës së UÇK-së.

Me iniciativë të Edi Ramës vitin e kaluar Shqipëria ka iniciuar rezolutë në Këshillin e Evropës kundër raportit të Dick Martyt mbi bazën e të cilit është themeluar Gjykata Speciale. Rama në një intervistë televizive para disa ditësh ka bërë me dije se i ka mbledhur nënshkrimet në Këshillin e Evropës për ta shtyrë përpara rezolutën e sponsorizuar nga Shqipëria. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi gjenden në paraburgim në Hagë që nga 5 nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Në fillim të këtij procesi gjyqësor, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm.

## Supremja refuzon kërkesën e mbrojtjes, lë në paraburgim ish-kryeshefin e KEK-ut

Prishtinë, 17 maj - Gjykata Supreme e ka refuzuar të pabazë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj të pandehurit Nagip Krasniqi, ish-kryeshef i KEK-ut, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Supremja e ka vlerësuar të pabazë kërkesën e mbrojtjes për lirim nga paraburgimi të Krasniqit. "Kolegji i Gjykatës Supreme e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj të pandehurit N.K., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Në çështjen penale ndaj të pandehurit N.K., për shkak të veprave penale: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, ushtrimi i

ndikimit, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, konflikti i interesit, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurit, avokatët Virtyt Ibrahimaga dhe Taulant Ferizi, në seancën e mbajtur më datë 16.05.2023, kolegji i Gjykatës Supreme vendosi për refuzimin e kësaj kërkesë", thuhet në njoftimin e Supremes.

Krasniqi është arrestuar më 19 prill nën dyshimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare, ushtrimit të ndikimit dhe konfliktit të interesit. "Gjatë bastisjes janë sekuestruar dokumente të ndryshme që ndërlidhen me rastin, pajisje elektronike si tre (3) kompjuter, një (1) llap-top, një (1) celular, një (1) USB, në cilësi të provave materiale që do të shërbejnë për procedurën e mëtejme", kishte njoftuar prokuroria.



## Caktohen datat për zgjedhjet evropiane

**BRUKSEL, 17 MAJ** - Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të mërkurën që zgjedhjet e ardhshme evropiane të mbahen më 6 dhe 9 qershor 2024. Sipas vendimit, që e ka dhënë Këshilli i BE-së, qytetarët e 27 vendeve anëtare do të zgjedhin 705 deputetë të Parlamentit Evropian për mandatin nga vitit 2024 deri në vitin 2029.

BE-ja zakonisht cakton një afat katërditor, brenda të cilit vendet anëtare duhet t'i mbajnë zgjedhjet për Parlamentin Evropian. Në disa vende, si Holandë, votohet gjithmonë

ditën e enjte, ndërsa shumë vende tradicionalisht i zhvillojnë zgjedhjet gjatë fundjavës, kryesisht ditën e diel.

Zgjedhjet për institucionet e BE-së mbahen në fund të muajit maj, por kësaj radhe vendet e bllokut i kanë caktuar ato dy javë më vonë. Numri i deputetëve të Parlamentit Evropian ndahet mes vendeve anëtare, duke pasur parasysh numrin e banorëve të tyre, por ka një diskriminim pozitiv në favor të vendeve më të vogla.

Asnjë shtet nuk mund të ketë më pak se gjashtë deputetë, sa kanë Malta, Qiproja dhe

Luksemburgu, dhe asnjë vend nuk mund të ketë më shumë se 96 deputetë sa ka Gjermania. Por, kjo do të thotë se për t'u zgjedhur deputet në Parlamentin Evropian, një kandidati gjerman potencialisht i duhen 10 herë më shumë vota sesa një kolegu të tij në Maltë apo Qipro.

Pas zgjedhjeve evropiane pason edhe zgjedhja e Komisionit të ri Evropian, presidentit të Këshillit dhe funksioneve të tjera të larta në institucionet e BE-së.

Presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, u ka bërë ftesë të mërkurën qytetarëve të BE-së që të dalin në zgjedhje

evropiane, të votojnë për kandidatët e tyre dhe të mos lejojnë që dikush tjetër të vendosë në vend të tyre. "Bashkimi Evropian po zhvillohet pandërprerë. Bota po ndryshon. Duhet të ndryshojmë me të. Nuk mund të kemi frikë nga ndryshimet. BE-ja nuk është e përsosur. Këtë duhet ta pranojmë, por do të vazhdojmë njëkohësisht të dëgjojmë, sqarojmë dhe të punojmë për arritjen e rezultateve", ka thënë Metsola, duke i ftuar qytetarët të jenë "pjesë e aktivitetit më të madh demokratik në Evropë", duke iu referuar zgjedhjeve

evropiane.

Parlamenti Evropian është shumë i interesuar të ketë dalje sa më të madhe në këto zgjedhje, pasi deri tash, që prej vitit 1979 - kur janë zhvilluar zgjedhjet - e deri në vitin 2014, përqindja e atyre që kanë votuar ka qenë vazhdimisht në rënie.

Në zgjedhjet e vitit 2019, për herë të parë pas një kohe të gjatë, në zgjedhje dolën mbi 50 për qind e qytetarëve. Por, dallimi ishte shumë i madh, pasi në Belgjikë dhe Luksemburg votuan afër 90 për qind e qytetarëve e në vendet si Sllovakia, Sllovenia dhe Çekia, më pak se 30 për qind.



## Zbulohet busti i dëshmorit Skender Skenderi

**SKENDERAJ, 17 MAJ** - Në Vajnik të Skenderajt është bërë zbulimi i bustit të dëshmorit Skender Skenderi, në një manifestim që është mbajtur për nder të ditës së shkollës, si dhe me rastin e 24-vjetorit të rënies së heroit për lirinë e Kosovës. Në këtë shënim kanë marrë pjesë kryetari i komunës,

Fadil Nura, nënkryetari Sami Lushtaku, drejtorët komunalë, komandantë të UÇK-së, deputetja Ganimete Musliu, bashkëluftëtarë, qytetarë, nxënës dhe mësimdhënës.

Kryetari Nura në fjalimin e tij me rastin e ditës së shkollës ka thënë se është nder për të që

të marrë pjesë në kremten e shkollës dhe në mënyrë të veçantë në zbulimin e bustit të dëshmorit Skender Skenderi.

Vlen të përmendet se vitin e kaluar kreu i komunës kishte premtuar ndërtimin e bustit për heroin e Kosovës, kurse sot ai premtim u bë realitet.



## Aksion kundër fajdesë në Prishtinë dhe Podujevë, bastisen shtëpi dhe lokale



**FERIZAJ, 17 MAJ** - Prokuroria Themelore në Ferizaj, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda (DHKR) në Prishtinë dhe njësitë e tjera mbështetëse, në bazë të urdhëresës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj për lëshimin e urdhëresës për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm të shtëpive dhe lokaleve përcjellëse, të mërkurën ka realizuar një aksion kundër fajdesë. "Gjatë këtij aksioni janë duke u kontrolluar dhe bastisur shtëpi dhe lokale përcjellëse në lokacione të ndryshme, konkretisht në qytetin e Prishtinës dhe Podujevës, për shkak të dyshimit të veprave penale 'Fajdeja' nga neni 331, paragrafi 3, lidhur me paragrafin

1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, 'Shmangia nga tatimi', nga neni 307, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së, 'Detyrimi', nga neni 328, paragrafi 2 i KPRK-së dhe 'Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozi të paligjshëm', nga neni 294, paragrafi 3 i KPRK-së", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Ferizaj.

Lidhur me këtë aksion me vendim të prokurorit të shtetit janë ndaluar katër persona të dyshuar në kohëzgjatje prej 48 orësh për shkak të dyshimit të bazuar të veprave penale të lartcekura. Prokuroria Themelore në Ferizaj ka theksuar se do ta mbajë të informuar opinionin lidhur me këtë aksion.

## Mbahet manifestimi kombëtar 'Festa e Abetares'

**GJAKOVË, 17 MAJ** - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka organizuar manifestimin kombëtar "Festa e Abetares", i cili këtë vit është mbajtur në Palestrën Sportive "Shani Nushi" në Gjakovë, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve nga Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës dhe Maqedonia e Veriut, si dhe mësimdhënës, nxënës e prindër nga këto vende.

Në një fjalë rasti, zëvendësministrja e Arsimit, Edona Maloku-Bërdyna, tha se kjo festë është një traditë e çmuar në arsimin e kulturën tonë. "Është momenti kur fëmijët tanë marrin hapat e tyre të parë në botën e mrekullueshme të shkrimit e leximit, kur ata zbulojnë magjinë e fjalëve, të



shprehurit dhe komunikimit. Kjo festë na jep mundësinë ta kujtojmë rëndësinë e arsimit dhe rolin që secili nga ne kemi si mbështetës të palëkundur të

arsimimit e zhvillimit të fëmijëve tanë", theksoi ajo.

Maloku-Bërdyna uroi fëmijët për të cilët tha se janë shpresat e nesërme dhe thesaret tona më të

çmuara, ndërsa i falënderoi mësimdhënësit, të cilët, përmes punës së palodhshme, i ndihmojnë fëmijët ta shtojnë potencialin e tyre dhe i përgatitin

për sfidat e ardhshme që i presin. Ajo i ftoi prindërit të jenë partnerë aktivë në rrugëtimin arsimor të fëmijëve, duke i inkurajuar të lexojnë, shkruajnë dhe zbulojnë bukurinë e botës së librave e të dijes. "Tani që e kemi edhe Abetaren e Përbashkët, si bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Arsimit në Kosovë e Shqipëri, rrugëtimi i të gjithë fëmijëve dhe i neve të tjerëve që i mbështetim në këtë drejtim ka një emërues të përbashkët, atë të përbashkimit, arsimit cilësor dhe të zhvillimit të qytetarëve që janë kontribues të vlefshëm të shoqërisë e të vendit", tha z Maloku-Bërdyna.

Në këtë ngjarje tradicionale, e cila shënon përmbylljen e mësimit të shkronjave, u mbajt edhe një program festiv i fëmijëve të klasave të para.

## Lirohen hapësirat publike të uzurpuara në kryeqytet

**PRISHTINË, 17 MAJ** - Drejtoria e Inspeksionit në Prishtinë ka liruar hapësirën publike në afërsi të stacionit të trenit në kryeqytet e cila shfrytëzohej ilgalisht nga shitës të materialeve të ndryshme ndërtimore. Në përfundim të procesit të

lirimit, hapësirat e liruara (rreth gjysmë hektari) i ka vizituar edhe kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama.

Kryetari Rama ka përgëzuar punën e Drejtorisë së Inspektoratit si dhe ka ofruar mbështetjen e tij të

plotë për punën e jashtëzakonshme të inspektoratit.

U bë me dije se kjo hapësirë në të ardhmen do të shndërrohet në një hapësirë të gjelbër dhe atraktive për banorët e kryeqytetit që jetojnë në atë zonë.



# Mbahet konferenca e parë e përdoruesve të rrjetit kosovar për hulumtim dhe edukim

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 MAJ - Në ambientet e Universitetit të Prishtinës është mbajtur Konferenca e Parë e Përdoruesve të Rrjetit Kosovar për Hulumtim dhe Edukim (KREN), e cila do t'i shërbejë komunitetit për hulumtim, edukim si dhe përdoruesve të KREN për rrjetëzim, informim dhe zhvillim. Qëllimi kryesor i kësaj konference, ndër të tjera, është ngritja dhe zhvillimi i komunitetit të hulumtimit dhe edukimit në Kosovë, i cili qëllim është bërë i mundur falë një pune shumë të madhe të përbashkët nga Ministria e Ekonomisë, konkretisht projektit Ekonomia Digjitale e Kosovës (KODE), KREN dhe nga Banka Botërore.

KREN ka arritur ta centralizojë komunitetin e studentëve, studiuesve dhe stafit akademik në Kosovë, duke e lidhur Kosovën me Shoqatën pan-evropiane,

GEANT.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, pohoi se rrjeti KREN përmes shtrirjes së infrastrukturës fikse është një prej kontribuesve të zhvillimeve në arsim ku përmes funksionimit efektiv të tij, synojmë ta nxisim inovacionin dhe të zhvillojmë një infrastrukturë me shërbime të avancuara për institucionet e arsimit të lartë dhe të shkollave të mesme e fillore në të ardhmen e afërt, si dhe të fuqizojmë universitetet në Kosovë nga aspekti i ofrimit të mundësive teknologjike në arsim dhe hulumtim.

Ajo në fund tha se së bashku me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit janë duke punuar për sigurimin e qasjes në internet brezgjere dhe instalimin e rrjeteve të brendshme për shkollat e mesme dhe fillore në Kosovë, dhe ndërlidhjen e secilës së tyre në KREN.



Ndërsa ndër shërbimet e KREN-it për komunitetin e saj janë: Qasje në infrastrukturë si shërbim - qendra e të dhënave - për hapësirë në lidhje me përdorimin

e makinave virtuale; Resurseve të ndryshme procesorike që u nevojiten profesorëve e hulumtuesve; Qasje në platformën Moodle; Qasje në

internet të dedikuar me shpejtësi e siguri të lartë brenda dhe jashtë komplekseve të universiteteve; Ruajtje të të dhënave, Licenca Office 365 dhe të ngjashme.

## UP-ja e nderon me titullin 'Doctor Honoris Causa' profesorin Sean D. Murphy

PRISHTINË, 17 MAJ - Universiteti i Prishtinës i ka dhënë titullin "Doktor Nderi" profesorit Sean D. Murphy. Ky titull, i akorduar nga Senati i UP-së, iu dha atij për kontributin në mbrojtjen e pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë si dhe për avancimin e paqes dhe drejtësisë përmes së drejtës ndërkombëtare.

Në ceremoninë solemne të pranishëm ishin studentë, drejtues të Universitetit të Prishtinës, përfaqësues nga institucione partnere dhe personalitete nga fusha e ligjit dhe drejtësisë.

Fjalën hyrëse në këtë ceremoni e adresoi rektori, prof. dr. Qerim Qerimi, i cili tha se është nder i veçantë që t'ia japin titullin e nderit profesorit Murphy. "Si rektor i UP-së dhënia e këtij titulli më mbush plot nder. Puna dhe jeta e tij janë pishtarë për të na siguruar se drejtësia mbizotëron", ka theksuar Qerimi.



Në fjalën e tij ai lartësoi punën, por edhe personalitetin e profesorit Murphy. "Një studiues

i dalluar, një shërbyes publik i përkushtuar dhe një shembull i ndershmërisë, profesori Murphy

na paraqitet si dëshmi e ndikimit të transformueshëm që një person mund të ketë në botë.

Duke i dhënë diplomën e nderit, ne festojmë arritjet e tij të jashtëzakonshme dhe marrim mësim të çmuar nga jeta e tij dhe kontributi për komunitetin tonë", është shprehur rektori Qerimi.

E për shpërblimin me titullin e nderit të UP-së, laureati Sean D. Murphy u shpreh mirënjohës. Ai me të pranishmit ndau përvojën për përfshirjen e tij në çaste historike për popullin e Kosovës. Sipas tij, ndonëse e vogël gjeografikisht, Kosova është një vend i veçantë në krahasim me vendet e tjera të botës. "Shpesh u them studentëve të juridikut, që nëse kërkoni një vend ku është shënuar kthesa më e madhe e këtij shekulli në fushën e së drejtës ndërkombëtare, ajo është Kosova", ka pohuar Murphy. Ai shtoi që është shumë mirënjohës dhe falënderues që UP-ja ia ka ndarë këtë titull nderi. "Unë me krenarinë më të madhe e pranoj këtë", ka theksuar Murphy.

## Kurti bashkëbisedon me studentët e Akademisë Diplomatike të Vjenës

PRISHTINË, 17 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar të mërkurën një bashkëbisedim me studentët e Akademisë Diplomatike të Vjenës në ambientet e Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Kurti ka shprehur mirënjohjen e tij të përzemërt për Akademinë Diplomatike të Vjenës lidhur me organizimin e këtij udhëtimi studimor e i cili, siç potencoi ai, na lejon të diskutojmë dhe eksplorojmë

arritjet e republikës sonë. Para studentëve kryeministri Kurti, derisa foli për 15-vjetorin e pavarësisë së Kosovës, sfidat, arritjet e sukseset, veçoi edhe qëndrimin ambicioz të qeverisë që ai udhëheq ndaj reformave demokratike në të gjithë sektorët e qeverisë, veçanërisht sigurimin e një sistemi më të fortë të mirëqenies, forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjen dhe përfundimin e të drejtave të

njeriut, përfshirë të drejtat e minoriteteve dhe rritjen e ekonomisë. Ky përparim, theksoi ai, është njohur gjerësisht nga raporte të shumta ndërkombëtare, duke forcuar reputacionin e Kosovës si një histori suksesi në shtetin e demokracisë. Në këtë takim të kryeministrit Kurti me studentët nga Akademia Diplomatike e Vjenës, i pranishëm ishte edhe ambasadori i Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger.



## Brenda pak javësh hapen procedurat për ndërtimin e urës së re në Badovc

PRISHTINË, 17 MAJ - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije se brenda pak javësh do të hapen procedurat për hartimin e projektit kryesor të ndërtimit të urës së re në Badovc. "Punimet në Bypass po ecin me ritme të shpejta. Po

punohet intensivisht në asfaltim, rjedhimisht përmes kontratës së mirëmbajtjes investive ky Bypass do të jetë i asfaltuar dhe gati për lëvizje të automjeteve. Pas formimit të Komisionit Profesional nga MMPHI, është bërë vlerësimi se në aksin rrugor Prishtinë - Gjilan, tek ura e

Badovcit, e cila njëherësh përballon një fluks të lartë lëvizjeje të automjeteve, e që për shkak të rrezikshmërisë në aspektin e sigurisë, kemi marrë vendimin që këtë urë ta mbyllim përkohësisht deri në hartimin e projektit kryesor të ndërtimit të urës së re", ka thënë ministri Aliu.



## PDK-ja inicion ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronë

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 MAJ - Koordinator i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë i Partisë Demokratike të Kosovës, Arben Mustafa, në një konferencë për medie ka njoftuar se grupi parlamentar i PDK-së ka iniciuar në Kuvendin e Kosovës ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronë e Paluajtshme.

Mustafa ka thënë se kjo nismë është ndërmarrë pas dyfishimit të faturave të tatimit në pronë për vitin 2023 për pjesën më të madhe të qytetarëve të Kosovës. "Kjo rritje e barrës tatimore erdhi në kohën kur mirëqenia e qytetarëve u rëndua së tepërmi për shkak të rritjes së çmimeve. Pra, në kushtet kur norma e rritjes së çmimeve arriti nivele të papara në historinë e re të Kosovës, ndërsa të ardhurat e qytetarëve mbetën përgjithësisht të pandryshuara dhe shumë familje rrezikojnë të lëvizin drejt pragut të varfërisë, është absolutisht e papranueshme që qytetarët të rëndohen edhe më shumë nga rritja e tatimit në pronë", ka thënë ai.

Në Projektligjin e iniciuar nga grupi parlamentar i PDK-së është propozuar pezullimi për një vit i vlerësimit të pronave që është bërë në vitin 2022 nga ana e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në mënyrë që tatimi në pronë të mos rritet në këto kushte të rënduara ekonomike.



PDK-ja i ka ftuar të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta mbështetnin këtë Projektligj. "Ky ndryshim dhe plotësim i Ligjit 06/L-005 për Tatimin në Pronë e Paluajtshme do të mundësojë aplikimin e vlerësimeve të pronave dhe faturave tatimore që kanë qenë deri në vitin 2022. Gjithashtu, është propozuar që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të organizojë një proces të ri vlerësimi të pronave të paluajtshme. Vlerësimi i ri i pronave duhet të mbështetet në një proces profesional dhe transparent, ku qytetarët dhe komunat do t'i

kenë të qarta metodologjinë dhe kriteret mbi të cilat është bazuar vlerësimi i ri pronave. Po ashtu, përmes kësaj nisme ligjore kemi propozuar të obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që të propozojë amendamentet e nevojshme ligjore me të cilat ndryshohet pragu i poshtëm prej 0.15-përqindësh i përcaktuar në nenin 9 të ligjit bazë, në mënyrë që t'u mundësohet më tepër fleksibilitet komunave që ta bëjnë përshtatjen e normave të tatimit në pronë sipas rrethanave ekonomike. Prandaj, ftojme deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i japin

mbështetje këtij projektligji", ka thënë ai.

Mustafa i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës për vlerësim pozitiv sa i përket kësaj nisme ligjore të grupit parlamentar të PDK-së dhe kjo çështje të adresohet sa më shpejt që është e mundur. "Mbështetja e këtij projektligji do të krijojë sadopak lehtësi për qytetarët e vendit që po ballafaqohen me mirëqenie të rënduar dhe do t'i japë mundësi një procesi të ri të vlerësimit të pronave, të bazuar në transparencë dhe në një përfshirje më të gjerë të palëve relevante për vlerësimin e pasurive të paluajtshme. Çdo

tentativë tjetër për ta zhvendosur vëmendjen nga ngarkesa e panevojshme që u është vënë qytetarëve të vendit sikur tendenca për t'ua bartur komunave përgjegjësinë e faljes ose jo të 100 eurove, paraqet vetëm një vazhdim të përpjekjeve për manipulim me publikun dhe ikje nga përgjegjësia e veprimeve të palogjikshme dhe të pamatura politike. Kërkojmë zgjidhje të qëndrueshme, jo të bazuar në hapa ad-hoc siç po vepron qeveria me projektligjin aktual. Pra, një zgjidhje të strukturuar dhe në favor të qytetarëve të Kosovës", ka thënë Arben Mustafa.

## ATK-ja hap të dhënat për 'Të hyrat tatimore 2017-2023'

PRISHTINË, 17 MAJ - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka vazhduar publikimin e dataseteve për të dhëna të hapura. Këtë herë janë publikuar të dhëna mbi të hyrat tatimore nga viti 2017 deri në 2023.

Dataseti i 'Të hyrave tatimore' është publikuar në linkun e Open Data në faqen zyrtare të ATK-së dhe brenda këtyre seteve qytetarët mund t'i gjejnë të dhënat e specifikuar sipas katalogut të paraparë në këto kategori: pagesat për vit, muaj, statusi i

regjistrimit, numri i tatimpaguesve, përshkrimi i sektorit sipas komunave si dhe lloji i formularit të deklarimit.

Publikimi i të dhënave të hapura nga ana e ATK-së do t'i ndihmojë qytetarët/organizatat e ndryshme që të njoftohen më shumë rreth tatimeve dhe t'i përdorin ato të dhëna për analiza të ndryshme. Gjithashtu, kjo do të ndihmojë në informimin e opinionit publik në lidhje me krahasimin e zhvillimit të ATK-së ndër vite me

publikimin e materialeve krahasuese dhe të informatave të tjera relevante.

Hapja e të dhënave është çelës për çdo institucion e organizatë për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Administrata Tatimore e Kosovës çdoherë ka qenë e fokusuar përmes planeve strategjike për rritjen e mekanizmave të cilët çojnë përpara integritetin e institucionit.

Iniciativa për hapjen e të dhënave kontribuon në




zhvillimin demokratik të një institucioni si dhe zhvillimin

e një segmenti ekonomik në nivel inovativ.



# Teoritë kontradiktore për ekzistencën e Homerit



Nga: Alice FIGINI

Homeri ka qenë një personazh që ka ngjallur gjithmonë mosmarrëveshje midis studiuesve. A ka ekzistuar vërtet autori i *Iliadës* dhe *Odisesë*? Ky dyshim është ngritur që në kohët e lashta, dhe saktësisht në shekullin VII p.e.s. kur Kalinusi nga Efesi iu referua qarkullimit të veçantë të dy poezive, të cilat nuk mund të ishin shkruar nga i njëjti person.

Debati u thellua në epokën moderne, me botimin e traktatit "Prolegomena ad Homerum" nga Fridrih Volf në vitin 1795, që shënoi fillimin e një sërë studimesh të kritikës analitike mbi poemat homerike, veçanërisht mbi *Iliadën*, që ishte teksti më i fragmentuar dhe më asimetrik. "Çështja" ka vazhduar deri në ditët e sotme, dhe mbetet kryesisht ende e pazgjithur si enigmë.

## Çështja homerike sipas grekëve

Çështja homerike filloi që në kohët e lashta, në shekullin III p.e.s., kur disa studiues të gramatikës filluan të studionin tekstet greke që gjendeshin në Bibliotekën e Aleksandrisë në Egjipt. Kështu lindi një disiplinë e shkëlqyer e quajtur filologji, por edhe një enigmë e madhe.

Duke analizuar tekstet, studiuesit aleksandrianë, Ksenoni dhe Elaniku, zbuluan dallime të mëdha midis *Iliadës* dhe *Odisesë*, duke ngritur hipotezën se ato nuk i përkisnin të njëjtit autor apo se ky nuk kishte ekzistuar kurrë. Sipas studiuesve, vetëm *Iliada* është shkruar nga Homerit.

Teza e tyre u kundërshtua me vendosmëri nga Arstarku i Samotrakës, që pretendonte se *Iliada* ishte shkruar kur poeti grek ishte i ri, ndërsa *Odisea* ishte një vepër e shkruar nga Homerit në një moshë më të pjekur.

## Çështja homerike në epokën modern

Pas shumë vitesh heshtje dhe përpjekjesh intelektuale, çështja homerike u ringjall me forcë në shekullin XVII. Në atë kohë, Abati d'Obinjak shkroi një disertacion pasionant mbi *Iliadën*, në të cilën ai teorizoi se Homerit nuk kishte ekzistuar kurrë, dhe se në realitet poema e tij ishte një përzierje këngësh të ndryshme të lindura nga tradita gojore të kompozuar në faza të ndryshme.

Ndërkohë, historiani dhe filozofi Xhiambatista Viko hodhi hipotezën se dy poezitë ishin në të vërtetë një vepër kolektive, e krijuar nga i gjithë populli grek. Sipas tij, nën emrin Homerit fshiheshin një mori

bardësh, këngëtarë që e argëtonin publikun në fillim me bëmat e Akilit dhe më pas me ato të Odiseut.

Viko i justifikoi kontradiktat e brendshme të *Iliadës* dhe *Odisesë* me të qenit në fillim rrëfime gojore, të shtjelluara nga disa autorë anonimë. Për më tepër, sipas studiuesit Homerit nuk kishte ekzistuar kurrë, ai ishte një personazh i lindur nga një legjendë. Në shekullin XVIII, kjo hipotezë u mbështet nga filologu gjerman Friedrich Volf.

## Çështja homerike në epokën bashkëkohore

Një kontribut interesant në studimet homerike u dha në vitin 1928 nga Milman Perri. Duke analizuar traditën epike sllave të kohës së tij, studiuesi amerikan gjeti disa pika të përbashkëta me poemat homerike. Prandaj, sipas teorisë së tij, *Iliada* dhe *Odisea* ishin produkt i trashëgimisë orale, siç dëshmohej nga epitetet e ndryshme – formulat e përsëritura për të identifikuar personazhet (p.sh. *perëndeshë me krahët e bardhë*) – të përdorura për të lehtësuar memorizimin e këngëve.

Ndërkohë në vitet '90 të shekullit XX, helenisti Vinçenco Di Benedeto deklaroi se *Iliada* është vepër e një autori të vetëm, të cilin ai e identifikon me emrin e Homerit. Sipas

gjykimin të studiuesit, tek kjo vepër kemi një teknikë rrëfimore unitare që nuk i atribuohet autorëve të ndryshëm anonimë.

Di Benedeto mendon se *Odisea* mund të jetë vepër e një poeti tjetër. Sot, studimet mbi veprën homerike janë shumë të polarizuara. Sipas analizës gjuhësore të studiuesit britanik Martin L. Uest, këngët e *Iliadës* dhe *Odisesë* paraqesin një strukturë të qartë unitare, dhe për këtë arsye arritën në një version përfundimtar përpara se të shpërbëheshin në traditën gojore.

Uest vë në pikëpyetje teorinë e Parrit, duke deklaruar se në bazë të poemave homerike ekziston një projekt i qartë origjinal, më pas i zgjeruar nga trashëgimia popullore orale, që dikur këndonte legjendat e traditës.

## Atëherë kush ishte në të vërtetë Homerit?

Një nga dëshmitë historike për ekzistencën e tij na vjen nga Pindari, i cili pretendon se Homerit ka lindur në qytetin e Smirnës në Turqinë e sotme. Nga ana tjetër, Herodoti e gjurmon ekzistencën e Homerit 400 vjet më parë para kohës së tij dhe pohon se ai ka lindur në Melesigenes, në lumin Meleto. Tregimi i Herodotit, i përfshirë në librin *Vita Herodotea*, thotë

se Homerit nuk ishte emri i vërtetë i poetit, por një pseudonim që iu dha më vonë. Në fakt, Homerit rrjedh nga fjala 'ho m hor n' që do të thotë "ai që nuk sheh". Në fakt edhe legjenda thotë se Homerit ishte i verbër.

Ndërkohë, poeti Hesiod e konfirmon ekzistencën reale të Homerit, duke pretenduar se ai ishte një nga bashkëkohësit e tij, dhe pretendon se një ditë ata lexuan së bashku poezitë e tyre përkatëse gjatë një konkursi mbi poezinë. Por, të gjitha këto rindërtime historike mbi figurën e Homerit janë në kontrast me njëra-tjetrën.

Nuk është ende e mundur t'i jepet një datë e caktuar figurës së tij, dhe as një gjeografi e saktë e përkatësisë etnike. Megjithatë, ka shumë statuja dhe vende të shenjta të ngritura për nder të tij, të cilat tregojnë se si grekët e lashtë e nderonin poetin si një figurë hyjnore, të frymëzuar drejtpërdrejt nga muzat. Prandaj është një personazh legjendar, i rrethuar nga një atmosferë e shenjtë hyjnore. *Iliada* dhe *Odisea* mund të konsiderohen për grekët e lashtë, ajo që është Bibla sot për popullin e krishterë. Ajo nuk ishte thjesht një mit, por një rrëfim që jepte vlera, mendime, urdhërime dhe mund t'i atribuohet vetëm një autori legjendar, Homerit, më i madh se vetë emri i tij. /Sololibri/Në shqip nga: bota.al/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Sonte në 'Minatori' vendoset titulli i kampionit

MITROVICË, 17 MAJ - "Ajka për në fund". Edicioni 2022-23 në Prince Caffè Superligë do të përmbillet me superderbin ndërmjet Trepçës dhe Pejës. Kjo është finalja e pestë e "play-off"-it dhe do të vendosë se kush do të shpallet kampion. 2:2 është seria finale, ndërsa të dyja skuadrat e duan titullin pas një dekade. Edicioni po përmbillet me supersfidë, ndërsa ka qenë një nga më interesantit në vitet e fundit, kurse interesimi ka qenë i jashtëzakonshëm, sidomos gjatë garave shtesë. Në katër takimet finale mitrovicasit dhe pejanët kishin fituar si vendas. "Xehetarët" fituan 94:86 dhe 97:90, kurse "verdhezinjtë" fituan 107:79 dhe 87:83. Të enjten mbrëma nga ora 20:00 palestra "Minatori" pritet të jetë e stërbushur, ashtu si ka qenë



në pjesën më të madhe të këtij edicioni, ndërsa përveç kampionit do të vendoset se kush do të shpallet MVP. Mitrovicasit për herë të fundit ishin shpallur kampionë më 2012, kurse pejanët një vit më vonë, 2013. Në këtë edicion mitrovicasit fituan Kupën, kurse pejanët ishin finalistë të Ligës Ballkanike. Për të depërtuar deri në finale, Trepça kishte eliminuar Bashkimin dhe Sigal Prishtinën, ndërsa Peja eliminoi Golden Eagle Yllin.

### Kampionët e pasluftës (M)

- 1999-2000 Trepça
- 2000-01 Trepça
- 2001-02 Prishtina
- 2002-03 MEB Prishtina
- 2003-04 Kastrioti (LPBK Dukagjini)
- 2004-05 Mabetex
- 2005-06 Sigal Prishtina
- 2006-07 Sigal Prishtina
- 2007-08 Sigal Prishtina
- 2008-09 Sigal Prishtina
- 2009-10 Sigal Prishtina
- 2010-11 Sigal Prishtina
- 2011-12 Trepça
- 2012-13 Peja
- 2013-14 Sigal Prishtina
- 2014-15 Sigal Prishtina
- 2015-16 Sigal Prishtina
- 2016-17 Sigal Prishtina
- 2017-18 Bashkimi
- 2018-19 Z Mobile Prishtina
- 2019-20 i ndërprerë (COVID-19)
- 2020-21 Golden Eagle Ylli
- 2021-22 Golden Eagle Ylli
- 2022-23 ?

### KAMPIONËT E KOSOVËS NDËR VITE

- 1990-91 Prishtina
- 1991-92 Trepça
- 1992-93 Peja
- 1993-94 Peja
- 1994-95 Peja
- 1995-96 Peja
- 1996-97 Drita

## City shkatërron Realin, kualifikohet në finale 55


MANCHESTER, 17 MAJ - Manchester City-Inter është finalja e këtij sezoni në Ligën e Kampionëve dhe që do të luhet më 10 qershor në Stamboll. Skuadra e Pep Guardiols ka shkatërruar Realin e Madridit (4-0) në ndeshjen e kthimit të luajtur në "Etihad Stadium". Në minutën e 23-të do të vinte dhe golit për vendasit. Bernardo Silva shkëputet mjaft mirë në zonë

dhe më një të majtë të fortë e dërgon në trekëndëshin e portës. City nuk u mjaftua me kaq dhe vijoi presionin ndaj Realit, duke gjetur dhe golin e dytë. "Etihad Stadium" shpërtheu festa në minutën e 37-të, me Bernardo Silvën, i cili edhe pse shtatshkurtër e ndjek mjaft mirë aksionin për ta dërguar topin në kuadrat me kokë. Më pas në pjesën e dytë, skuadra

angleze do të administronte rezultatin, por dhe do të realizonte dhe dy gola të tjerë. Në minutën e 76-të, pas zhvillimeve të një goditje dënimi, Akanji godet në zonë me kokë dhe më pas Militao e devijon topin në rrjetën e portës së tij. Në minutat shtesë të ndeshjes, Julian Alvarez tregon klasin e tij dhe pse pak minuta në fushë, duke shënuar golin e katërt.



## Krasniqi më 5 gusht bokson në 'Fadil Vokrri'



PRISHTINË, 17 MAJ - Boksieri shqiptar Robin (Haxhi) Krasniqi nëpërmjet një video në "Facebook" ka bërë me dije se më 5 gusht në stadiumin e futbollit "Fadil Vokrri" në Prishtinë do të boksojë. "Pas një ëndre shumëvjeçare ju njoftoj se më 5 gusht në stadiumin 'Fadil Vokrri' në Prishtinë kemi

marrë vendim për të bërë një organizim për ndeshjen time të radhës që do të boksoj. Ju premtoj se do të jetë një natë e paharruar dhe i bëj ftesë të gjithë kombit shqiptar të na mbështetë dhe përkrahë me prani dhe të fitojmë e festojmë së bashku", ka thënë Krasniqi, i cili ka falënderuar kryetarin e


komunës së Prishtinës, Përparim Rama dhe kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, që mundësuan mbajtjen e këtij eventi në Prishtinë. Boksieri me prejardhje nga Juniku do të garojë në kategorinë gjysmë të rëndë, ndërsa emri i kundërshtarit do të jepet në ditët në vijim.

## Sonte përcaktohen finalistët e Ligës së Evropës

LEVERKUSEN, 17 MAJ - Sonte (e enjte) do të zhvillohen dy ndeshjet kthyesë të gjysmëfinalës në Ligën e Evropës dhe do të mësohen dy skuadrat finaliste në këtë garë. Bayer Leverkuseni do të kërkojë ta përmbysë rezultatin e ndeshjes së parë

ndaj Romës (1-0), por kjo s'do të jetë aspak e lehtë për faktin se klubi italian në krye me Jose Mourinon do ta kërkojë kalimin në finale dhe më pas edhe rrëmbimin e trofeut të Ligës së Evropës. Interesante do të jetë edhe në ndeshjen tjetër që

zhvillohet në "Estadio R. Sanchez Pizjuan", ku përballen Sevilla dhe Juventusit. Ndeshja e parë e zhvilluar në Itali një javë më parë ka përfunduar me rezultat 1-1, kurse sonte të dyja këto skuadra kërkojnë fitoren dhe kalimin në finale.



## FIA anulon garën për Çmimin e Madh të Imolas

**IMOLA, 17 MAJ** - Reshjet e dendura që kanë kapluar Italinë gjatë kësaj jave ka bërë që lumi Santero, në zonën e Emilia-Romagna të dalë nga shtrati dhe të shkaktojë përmbytje të mëdha e, si rrjedhojë, është anuluar edhe gara e Çmimit të

Madh të Imolas, të Formulës 1. Reshjet e shiut kanë përmbytur një pjesë të madhe të pistës por, për fat të mirë, nuk ka shkakuar dëme në njerëz, por vetëm materiale. Vendimi i anulimit të garës u dha me anë të një komunikate në rrjetet sociale.

FIA deklaroi se çmimi i Imolas nuk do të zhvillohet këtë javë, ndërsa nuk dihet nëse do të ketë shtyrje apo jo. “Në këtë gjendje ne nuk mund ta zhvillojmë çmimin e Imolas. Në këto kushte ne rrezikojmë shëndetin e tifozëve, pilotëve dhe stafit

drejtues. Prandaj gara e planifikuar për këtë javë nuk do të zhvillohet”, thuhet në komunikatën e FIA. Me rastin e anulimit të çmimit, fondet e mbledhura për organizimin e garës do t’u shkojnë familjeve që janë prekur nga përmbytja.



## Astera Tuhina, model për vajzat e Kosovës

**PRISHTINË, 17 MAJ** - Një nga basketbollistët më të talentuar të Kosovës padyshim është Astera Tuhina. 18-vjeçarja ka qenë pjesë e të gjithë grupmohave të Kosovës, ndërsa ka luajtur me Kosovën A te femrat në dy Kampionate Evropiane për Shtete të Vogla, ku së fundi kishte hyrë në Top 5 të turneut. Astera ka debutuar edhe në elitën spanjolle të basketbollit me vetëm 16 vjet, kurse më pas u transferua në ShBA, duke fituar trofe me Washington State Cougars, përkatësisht duke u shpallur kampione në PAC 12, që ishte turneu i parë për skuadrën nga Uashingtoni te femrat në këtë garë. Si një nga basketbollistët më të talentuar ajo do të vizitojë shkollat fillore në Kosovë dhe t’i motivojë vajzat e reja të merren me basketboll. Tuhina do të tregojë si ka arritur suksese në karrierën e saj dhe çfarë duhet të bëhet për ta ndjekur ëndrrën e tyre. Astera së



bashku me përfaqësuesit e FBK-së të enjten dhe të premten do t’i vizitojnë shkollat fillore në Prizren, Prishtinë dhe Pejë. Vizita zhvillohet në kuadër të kampanjës “HerWorld, Her Rules”.

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) është pjesë e projektit FIBA Europe Girls’ Program tash e pesë vjet dhe është duke implementuar

me mjaft sukses këtë projekt. “HerWorld, Her Rules” është një projekt unik dhe fushatë në mediet sociale, e udhëhequr nga FIBA Evropë që ka për qëllim ta promovojë basketbollin e femrave dhe vajzave nëpër Evropë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që realizohen në partneritet me federatat nacionale.

## Denveri mposhti lakersat në finalen e parë



**Denever, 17 maj** - Denveri fitoi me rezultat 132-126 ndaj lakersave në finalen e parë “play-off” në Konferencën e Perëndimit, duke udhëhequr 1-0 serinë. Një sfidë e jashtëzakonshme, mjaft e bukur dhe emocionuese mes dy skuadrave më të mira në këtë kah të NBA-së, që duan deri në fund. Një ndeshje ku kolektiviteti i Denverit bëri diferencën në fushë, me gjashtë

lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. Nikola Jokiçi ishte protagonist me një “triple-double”, me 34 pikë, 21 rebounde e 14 asistime, mbështetur edhe nga Jamal Murray me 31 pikë e Pope me 21 pikë. Lakersat duan deri në fund e shpresuan te fitorja por, pa sukses. Davisi e mbylli sfidën me 40 pikë e 10 rebounde, LeBron Jamesi me 26 pikë e Reaves me 23, por që s’mjaftuan për të fituar. Edhe

ndeshja e dytë do të luhet në fushën e Denverit.

**Konferenca e Lindjes,  
“Play-off” - Finale**  
Boston - Miami

**Konferenca e Perëndimit,  
“Play-off” - Finale**  
Denver - Lakers 132-126 (1-0)

### SHKURT

#### Leclerc: Synoj disa tituj me Ferrarin

Në moshën 25-vjeçare Charles Leclerc është në sezonin e tij të gjashtë në Formula 1, i pesti me Ferrari, ku ka arritur 5 fitore, 19 “pole position” dhe 25 podiume. Ai asnjëherë nuk ka mundur të duelojë për fitoren e titullit. Në prag të garës së Imolas, që zhvillohet në shtëpinë e “kokëkuqes”, piloti monogask shpreh optimizëm. “Këtë sezon dallimi me Red Bullin është më e madhe nga sa imagjinonim. Për këtë arsye jemi duke punuar shumë. Unë shpresoj të qëndroj sa më gjatë në Maranello. Unë jam i kënaqur këtu, pasi ka qenë gjithnjë ëndrra ime të jem një pilot i Ferrari”, u shpreh Leclerc. “Një nga ëndrrat e mia ka qenë të isha në Formula 1 e të pilotoja një Ferrari dhe e realizova këtë ëndërr. Por, nuk ndalem këtu, pasi dua të fitoj një titull. Madje disa të tillë nëse është e mundur. Dhe do të bëj maksimumin deri në fund të karrierës sime për ta realizuar këtë gjë”, ka thënë Leclerc.

#### Pioli: Interi e meritoi finalen

Trajneri i AC Milanit, Stefano Pioli, e pranon se skuadra e Interit e ka merituar më shumë kualifikimin në finale të Ligës së Kampionëve. Ai ka thënë se dëshpërim i madh do të ishte për skuadrën kuqezë nëse nuk e arrin të kualifikohet në Ligën e Kampionëve për sezonin e ri. “Lojtarët dhanë maksimumin, të flasësh për pak dëshirë nuk më duket e drejtë. Interi luajti më mirë sesa ne, e merituan finalen për atë që dhanë në të dyja sfidat. Në pjesën e parë luajtëm më mirë, krijuam 2-3 raste, nëse do të shënonim ndeshja mund të merrte një tjetër rrjedhë. Këtë vit u treguam kompetitivë në të dy frontet - në Serinë A dhe në Ligën e Kampionëve. Të dalësh nga Liga e Kampionëve pas një sfidë derbi është shumë zhgënjyese, por do të ishte më e rëndë nëse nuk do të arrijmë të kualifikohemi në Ligën e Kampionëve sezonin e ri. Nuk mund ta mbyllim sezonin në mënyrë negative”, ka thënë Pioli.

#### Inzaghi: Brenda një viti fituam katër derbi ndaj kampionëve të Italisë

Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, nuk e ka fshehur gëzimin për fitoren e skuadrës së tij dhe arritjen e parë të tij personale si trajner në një finale të Ligës së Kampionëve, pasi zikaltrit fituan 1-0 ndeshjen e kthimit ndaj Milanit. “Në ditët në vijim do të kuptojmë më mirë se çfarë kemi bërë. Për ne fillimisht ishte një ëndërr, por ne gjithmonë kemi besuar në të dhe kemi bërë një udhëtim të jashtëzakonshëm. Ka shumë kënaqësi dhe duhet t’i urojmë këta djem. Jam krenar për gjithçka që ata kanë bërë në fushë, vrapim, vendosmëri, agresivitet, përqendrim, të gjitha. Ata ishin shumë mirë, fituam katër derbi ndaj kampionëve të Italisë, jam i lumtur për djemtë e mi, është e drejtë që ata të shijojnë mbrëmje të tilla”, ka thënë Inzaghi. “10 qershori? Nuk ka premtime, por gjithmonë kam thënë se angazhimi do të ishte maksimal në të gjitha garat. Ka qenë një periudhë intensive për një muaj e gjysmë, por ne arritëm në dy finale dhe e kthyem rrugëtimin në kampionat siç duhet”, ka shtuar Inzaghi.

## Mane dhe Cancelo në verë largohen nga Bayerni

Bayern Muncheni ka marrë vendimin përfundimtar për të ardhmen e Sadio Manes dhe mbrojtësit portugez Joao Cancelo. Sulmuesi senegalez iu bashkua “bavarezëve” me

shumë bujë në verën e vitit të kaluar, por pa arritur të lë gjurmë të mëdha në Munchen. Për më tepër Mane shkaktoi një problem të madh kur goditi me grusht bashkëlojtarin e tij Sadio

Manen. Kampioni në fuqi i Gjermanisë ka vendosur ta nxjerrë në shitje Manen dhe senegalezi pritet të rikthehet në Angli, ku Liverpooli dhe Chelsea kanë shprehur interesim për të.

Për ta lënë të lirë senegalezin, Bayerni synon të fitojë rreth 40 milionë euro. Edhe mbrojtësi portugez Joao Cancelo nuk pritet të ketë të ardhme në Munchen, pasi bavarezët do ta largojnë atë.

Cancelo është i huazuar te Bayerni nga Manchester City, por gjiganti gjerman nuk pritet ta aktivizojë klauzolën për blerjen përfundimtare të tij prej 70 milionë eurove.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Posta Juaj” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811957416 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Posta Juaj” D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811957416 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Posta Juaj” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 811957416 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Connect With World” O.P. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810947450 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Connect With World” O.P. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810947450 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Connect With World” O.P. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810947450 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Qaush Nitaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Afrim Smjali shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".

Ramiz Latajnga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Autoservis Beni-VW AUDI-VAG shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 80273029.

Sadete Musa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I-V të sh.f. “Mustafa Bakija” Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

Sadete Musa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI-IX të sh.f. “Yll Morina” Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Drilon Imeri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” Prishtinë.

Sara Mustaf Ahmeti shpall të pavlefshme Diplomën e Bachelorit të Fakultetit Juridik Qendra në Gjiilan.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Brahim Ibishi shpall te pavlefshme dëftesat 1 deri 8 se shkollës fillore "Sefedin Smakolli.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Mentori B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 601640726.



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

